



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr. 21862/8 prot.

Tiranë, më 09.07.2021

Lënda: Informacion ne lidhje me marrjen ne dorezim te mjediseve te koncesionarit dhe infrastruktures

Zj. Belinda BALLUKU
MINISTËR
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

TIRANË

E nderuar Zj. Ministre,

Në zbatim të shkresës nr.8073 Prot, datë 17.11.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi përfundimin e kontratës koncesionare date 03.09.2009 “Për dhënie me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 3.6 “ Dorëzim i Mjediseve të Koncesionit dhe Infrastrukturës” Ministria ka caktuar autoritetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që koncesionari t’i kthejë të gjithë mjediset e koncesionit dhe infrastrukturës.

Në zbatim të urdhërit nr.349, datë 14.12.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, pika 2, „DPSHTRR ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural dhe administrative të parashikuar në pikën 3.7 të kontratës koncesionare si dhe çdo veprim tjetër administrativ i nevojshëm për t’u kryer, sipas legjislacionit në fuqi, pas përfundimit të procedurës së dorëzimit të kontratës koncesionare, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor ngriti grupin e punës me urdhërin nr.883, datë 26.11.2020 “ Për ngritjen e grupit të monitorimit me qëllim finalizimin e marrjes në dorëzim të mjediseve të koncesionit dhe infrastrukturës pas përfundimit të kontratës koncesionare MIE-SGS, për shërbimin e kontrollit të detyrueshëm teknik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, për të gjitha drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së”

Në referencë të shkresës nr. 8073/2 prot, datë 01.12.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Njësia e Zbatimit të Projektit Koncesionar na është përcjellë informacioni mbi asetet që dispononte SGS Automotive Albania dhe në të gjitha drejtoritë rajonale u ngritën komisione të inventarizimit të aktiveve afatgjata material e jomateriale për marrjen në dorëzim të tyre me urdhër të Drejtorit Rajonal përkatës. Këto grupe verifikuan dhe morën në dorëzim aktivet e qendrave të kontrollit teknik dhe mbajtën procesverbalet përkatës sipas listës. Nuk u morën në dorëzim vetëm pajisjet e regjistrimit elektronik fiskal (kasat fiskale).



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR

Adresa: Rr. “Muhedin Llagani” Nr.10.Tiranë;
Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail:dpshttr@dpshttr.gov.al; eëë.dpshttr.gov.al

Referuar kontratës nr.25176 prot, datë 28.12.2020 “Për vlerësimin e Aktiveve Afatgjatë Materiale (AAM) të Qendrave të Kontrollit Teknik, të vendimit nr.85 datë 16.12.2020 të Këshillit Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve dhe Transportit Krugor me objekt “Për vlerësimin e jetës aktive të aktiveve afatgjatë materiale të Qendrave të Kontrollit Teknik” dhe në mbështetje të Standarteve të Vlerësimit të aplikueshme, Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar, ligjit nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Kontratës së Konkensionit me nr. 4862/2 datë 03/09/2009 e cila përfundoi në datë 31/12/2020, nga grupi vlerësues në Raportin Përmbledhës dolën me konkluzionin :

Aktivet Afatgjatë Materiale sipas klasës dhe përkatësisë të çdo Qendre të Kontrollit Teknik në përfundim të procesit të vlerësimit janë si në tabelën në vijim:

a) Vlerat e AAM-ve sipas vlerësimit

Nr	Emertimi	Toka	Ndertesa	Infrastruktura	Makineri e Pajisje	Pajisje të Testimit	Pajisje IT	Mobilje	TOTALI
1	Berat	-	-	-	-	4,875,325	94,655	26,440	4,996,420
2	Diber	-	-	-	-	4,735,325	86,395	24,605	4,846,325
3	Durrës	-	-	-	-	13,411,900	179,125	54,070	13,645,095
4	Elbasan	-	-	-	-	7,063,325	102,225	26,470	7,192,020
5	Fier	-	-	-	-	7,229,325	106,165	27,970	7,363,460
6	Gjirokastër	-	-	-	-	6,668,175	99,355	25,640	6,793,170
7	Korçë	-	-	-	-	7,063,325	109,935	26,480	7,199,740
8	Kukës	-	-	-	-	4,766,100	93,645	20,020	4,879,765
9	Lac	-	-	-	-	4,678,025	85,755	36,820	4,800,600
10	Lushnjë	-	-	-	-	6,675,325	102,225	32,520	6,810,070
11	Shkodër	-	-	-	-	6,840,975	110,755	31,570	6,983,300
12	Sarandë	-	-	-	-	4,665,325	89,425	29,415	4,784,165
13	Tirana-1	52,787,260	27,140,550	20,597,134	8,678,874	15,981,575	185,820	45,660	125,416,874
14	Tirana-2	-	-	-	-	15,947,225	156,395	57,270	16,160,890
15	Vlorë	-	-	-	-	6,655,075	108,345	30,140	6,793,560
16	Drejtoria	-	-	-	-	-	11,000	-	11,000
	Totali	52,787,260	27,140,550	20,597,134	8,678,874	117,256,325	1,721,220	495,090	228,676,454

b) Problematika të tjera të hasura gjatë vlerësimit

- Toka është vlerësuar bazuar në çmimin e tregut edhe pse në fakt përdorimi saj është i njëjtë për nevoja të aktivitetit nga ana dokumentare figuron e ndarë në emërtim dhe zërin kadastral një pasuri si tokë arë dhe pasuria tjetër si tokë truall. Problematikë kjo e përcjellë me shkresën nr.7924 prot, datë 22.04.2021 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe NJZP-së dhe rezultoi se në MIE nuk është bërë asnjë kërkesë për aprovim.
- Për pompat e ujit, është realizuar identifikimi, matja dhe problematika me vendosjen në pasurinë 10/41, pronë që nuk është pjesë e procedurës së marrjes në dorëzim dhe vlerësimit.
- Për pajisjet e testimit është punuar në identifikimin, mbledhjen dhe kategorizimin e tyre pasi janë komplekse me përbërje fizike, elektronike dhe informatike. Është hasur problemi i paraqitjes në listen e inventarit të SGS-së, i pjesëve të ndërrimit, të cilat siç theksuam më lart, janë pjesë e shpenzimeve në periudhën kur ndodhin. Këto makineri dhe pajisje nuk gjenden me vlerë apo çmime në një treg të hapur dhe janë siguruar të dhëna nga shoqëri prodhuese (MAHA), shoqëri që shesin pajisje të përdorura dhe të dhëna të siguruar nga kopje të deklaratave doganore.



- Pajisjet informatike, bazuar nga verifikimi por jo vetëm, por edhe për sa është konstatuar nga Drejtoria IT e DPSHTRR-së, me shkresën nr.1687/1 datë 25.01.2021, janë kryesisht pajisje me vit prodhimi 2012 sistem operativ windos 7, i cili është “end of life, end of support, end of sale”.
- Godinat e marra në dorëzim janë të pa përmirësuara, me lagështirë . jo të mirëmbajtura dhe të amortizuara.

Vlen të theksohet se në momentin e dhënies me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik, koncesionarit (SGS Automotive Albania) ju dhanë asete të cilat ishin në pronësi të DPSHTRR-së, për fillimin e punës me vlerë 164.212.778 lekë. Pajisjet e testimit të mjeteve të cilat janë rikthyer përsëri pas dy vjetësh duke mos gjetur përdorim janë amortizuar. Gjithashtu në këtë vlerë janë përfshirë edhe godinat të cilat janë rikthyer tani në përfundim të kontratës së koncesionit, vlera e godinave të dhëna në përdorim pa pagesë shkonte në 152.771.790 lekë.

Bashkëlidhur Raporti Përmbledhës i Vlerësuesve.

Bashkëlidhur Raporti i vlerësuesve për çdo Qendër të Kontrollit Teknik.

Bashkëlidhur procesverbalet e marrjes në dorezim nga Drejtoritë Rajonale.

Ju faleminderit për vëmendjen,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Blendi GONXHJA

